



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/02-1164
Dt.07.05.2024.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	"RRONI FER" SH.P.K. me seli në Gjakovë, me NUI 810243668 dhe me pronar Labinot dhe Besfort Kameri nga Gjakova.		
Adresa:	Rruga "Skënderbeu" pn, Magjstralja Gjakovë-Prizren km -2.		
Telefoni:	048 544 980	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 100 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 618, dt. 19.01.2024, në objektin ekonomik ekzistues të kategorisë së dytë.		
Emri i Projektuesit:	"UNISOLAR L.L.C.		
Adresa:	Rruga "Gaspër Karaqi, pn. Magj Gjakovë – Prizren.		
Telefoni:	048 717 204	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga "Mark Malota".		
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-J-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 4210-7, 4210-5, 4210-2, 4215-2, 4216-3.	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

Përshkrimi:

- **Lejohet Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 100 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 618, dt. 19.01.2024, në objektin ekonomik ekzistues të kategorisë së dytë.**
- **Obligohet pala që pas pranimit të Lejes Ndërtimore – Instalimit të paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me të njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.**

Me këtë vendim, ”RRONI FER” SH.P.K. me seli në Gjakovë, me NUI 810243668 dhe me pronar Labinot dhe Besfort Kameri nga Gjakova, i lejohet Ndërtimi i sistemit solar me kapacitet 100 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 618, dt. 19.01.2024, në objektin ekonomik ekzistues të kategorisë së dytë, në parcelat me nr. 4210-7, 4210-5, 4210-2, 4215-2, 4216-3: Gjakovë-J_Qytet dhe njëkohësisht obligohet pala që pas pranimit të Lejes Ndërtimore – Instalimit të paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me të njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi – “UNISOLAR” L.L.C. me NUI 811501817m me seli në Gjakovë, në rrugën “Gaspër Karaqi, pn. Magj. Gjakovë – Prizren, në cilësinë e të Autorizuarit, bazuar në me Aktin Noterial – Autorizim nr. LRP.Nr. 12005/2023, dt. 07.09.2023 nga “RRONI FER” SH.P.K. me seli në Gjakovë, Rruga “Skënderbeu” pn, Magjistralja Gjakovë-Prizren km -2, me NUI 810243668 dhe me pronar Labinot dhe Besfort Kameri nga Gjakova, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-1164 të datës dt 26.01.2024 të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 100 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 618, dt. 19.01.2024, në objektin ekonomik ekzistues të kategorisë së dytë, në parcelat me nr. 4210-7, 4210-5, 4210-2, 4215-2, 4216-3, ZK: Gjakovë-J-Qyet në (qira mbajtje 99 vite) të “RRONI FER” SH.P.K Gjakovë.

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) në pronësi në qira mbajtje për 99 vite, (qira mbajtje 99 vite) të “RRONI FER” SH.P.K Gjakovë të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Lejen Mjedisore komunale me nr, 07/351/02-1167, 13.03.2024, lëshuar nga DUMM.
- Aktin Noterial – Autorizim nr. LRP.Nr. 12005/2023, dt. 07.09.2023.
- Aktin Noterial – Autorizim nr. LRP.Nr.2971/2021, ref. Nr. 730/2021, dt. 18.03.2021.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Pëlqimit Elektroenergetik, nga KEDS nr. 618, dt. 19.01.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “UNISOLAR L.L.C – Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim.

Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t’i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Zyrtari përgjegjës për lëndë

Durrije Berisha I.D.A.

Hartoi aktin

Zenel Shabani Z.L.Ligjor



Drejtori

Arben Bakalli

